

UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI EKONOMIK

Banka, Financa dhe Kontabilitet



MSc. SAFET ABDULLAHU

REFORMA DHE SFIDAT E EDUKIMIT

KONTABËL NË KOSOVË

PUNIM I DOKTORATËS

Prishtinë, 2023

UNIVERSITY OF PRISHTINA

FAKULTY OF ECONOMICS

Banking, Finance and Accounting



MSc. SAFET ABDULLAHU

**THE REFORM AND CHALLENGES OF
ACCOUNTING EDUCATION IN KOSOVO**

DOCTORAL THESIS

Prishtina, 2023

UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI EKONOMIK

Banka, Financa dhe Kontabilitet



MSc. SAFET ABDULLAHU

**REFORMA DHE SFIDAT E EDUKIMIT
KONTABËL NË KOSOVË**

PUNIM I DOKTORATËS

Mentori: Prof. Dr. Nexhmie Berisha-Vokshi

Prishtinë, 2023

Abstrakt

Profesioni kontabël është i rëndësishëm në jetën e një vendi, sepse ai jep kontribut në zhvillimin ekonomik dhe në stabilitetin financiar, në funksionimin eficient të tregjeve, të kapitalit dhe të sektorit publik. Profesioni i kontabilitetit nxit dhe mbështet rritjen dhe zhvillimin e biznesit në përgjithësi, sidomos të biznesit të vogël e të mesëm, duke iu dhënë atyre ndihmë në drejtimin strategjik e financiar dhe ka si objektiv mbrojtjen e interesave të aksionarëve dhe të publikut si investues të kapitalit.

Sistemi ekonomik i çdo vendi mund të funksionojë normalisht dhe pa shumë probleme në qoftë se drejtimi i çdo njësie ekonomike merr në tërësi një informacion të saktë dhe të shpejtë. Ndër informacionet e shumta që përdoret nga drejtimi i çdo njësie ekonomike, kontabiliteti luan rol të veçantë. Ai vazhdimisht dhe pa ndërprerje i siguron drejtimin të njësisë ekonomike dhe më gjerë, informacion të shpejt, të saktë, të dokumentuar e të shkruar në mënyrë rigorozë.

Në kushtet e zhvillimit global të ekonomisë botërore, që nga vitet 90-a, krahas të tjerave, kanë ndryshuar dukshëm edhe nevojat për aftësitë që duhet t'i zotërojnë profesionistët kontabël. Roli i tyre sot nuk kufizohet vetëm në grumbullimin, regjistrimin dhe raportimin financiar të transaksioneve që kryejnë bizneset, por është më i gjerë dhe përfshinë të gjitha funksionet që kryen njësia ekonomike.

Hulumtimin që e kam zhvilluar në kuadër të kësaj që u tha, ka pasur për qëllim analizimin e reformave dhe sfidat në edukimin kontabël në Kosovë. Hulumtimi është zhvilluar gjatë periudhës 2020-2021 në institucionet e arsimit të lartë në Kosovë, gjegjësisht me dekanë, prodekanë, profesorë, ku më pastaj është aplikuar hulumtimi edhe në shkollat e mesme me drejtues dhe profesorë të shkollave të kontabilitetit si dhe me shoqatat profesionale të kontabilitetit në Kosovë.

Mostra në secilin institucion ka qenë e rastësishme, ndërsa hulumtimi është zhvilluar nga intervistat me dekanë, prodekanë, drejtues shkollave dhe drejtues të shoqatave, kurse ai përmes pyetësorëve është realizuar me profesorë universitarë, profesorë të shkollave të mesme dhe me kontabilistë e auditues të ndryshëm në Kosovë.

Rezultatet e hulumtimit janë realizuar nëpërmjet programit SPSS (version 25), ndërsa për testet statistikore janë përdorur Analiza faktoriale dhe Regresioni.

Bazuar në rezultatet e hulumtimit, intervistave dhe pyetësorëve, mund të themi se edukimi kontabël në Kosovë duhet reformuar sa më shpejt që të jetë e mundur. Përmes hipotezave vërtetua se reformimi ka efekte pozitive edhe në zhvillimin profesional të organizatave të cilat ofrojnë shërbime të kontabilitetit, ndikon në përmirësimin e shërbimeve të kontabilistëve dhe audituesve, ka efekte pozitive në ngritjen e kriterëve të kurrikulës së aplikuar si dhe në përgjithësi përmirëson gjendjen e këtij sektori me rëndësi shumë të madhe dhe të pazëvendësueshme për vendin tonë , p-value <0.05.

Edhe në kuadër të edukimit kontabël dhe implementimit të mësimit online kuptuam se edukimi kontabël duhet trajtuar pasi ai ofronte një përmbajtje shumë të mirë dhe të përshtatshme për studentët. Konstatuam se SNE-të ndonëse gjenin zbatim më të gjerë, në shkollat e mesme, ky aplikim ishte i zbehtë, apo ende nuk ka nisur së zbatuari.

Bazuar në këto konstatojmë se, edukimi kontabël në Kosovë është në një gjendje të qëndrueshme por i cili duhet të reformohet, me qëllim të përshtatjes dhe arritjes së standardeve të nivelit botëror.

Fjalët kyçe: Edukimi kontabël, Arsimi i lartë, Sfida, Reforma

Abstract

The accounting profession is important in the life of a country, it contributes to economic development and financial stability, to the efficient functioning of capital markets and the public sector. The accounting profession promotes and supports the growth and development of business in general and especially small and medium business, giving them assistance in strategic and financial management and aims to protect the interests of shareholders and the public that invests capital in them. . The economic system of each country will be able to function normally and without many problems if the management of each economic unit receives a complete accurate and fast information. Among the many pieces of information used by the management of each entity, accounting plays a special role. Accounting, continuously and without interruption, provides the management of the entity and beyond with fast, accurate, rigorously documented and written information. In the conditions of the global development of the world economy, since the 90s, along with other changes, the skills that accounting professionals must possess have changed significantly. Their role is no longer limited to the collection, recording and financial reporting of transactions performed by businesses, but it has expanded to include the entire entity and the functions it performs.

As part of this I conducted research which aimed to analyze the reforms and challenges in accounting education in Kosovo. The research was conducted during 2020-2021 with Higher Education Institutions in Kosovo, ie with deans, vice deans, professors, then the research was applied in high schools with school principals and professors of accounting as well as with professional accounting associations in Kosovo. . The sample in each institution was random, while it was conducted with interviews with deans, vice deans, school leaders and association leaders, and through questionnaires was conducted with university professors, high school professors and accounting and various auditors throughout Kosovo. The research results are; conducted through the SPSS program (version 25), while statistical tests used Factor Analysis and Regression.

Based on the research results we can say that accounting education in Kosovo needs to be reformed and this should happen as soon as possible, based on the results of interviews and questionnaires. Through hypotheses we proved that the reform has positive effects on the professional development of organizations that provide accounting services, has an

impact on improving the services of accountants and auditors, has positive effects on raising the criteria of the applied curriculum and generally improves the situation of this sector of great importance and irreplaceable for our country, p-value <0.05 . Even in the context of accounting education and the implementation of online learning we understand that accounting education should be addressed as it provides a very good and suitable content for students. We find that SNEs find a wider application, while in high schools this application is weak, or have not yet begun to be implemented. Based on these we find that accounting education in Kosovo is in a stable state but needs to be reformed with aim to adapt and achieve the highest standards in the world.

Keywords: Accounting Education, Higher Education, Challenge, Reform